



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.675/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lista e Pavarur - Bekim Jashari, me seli në Skenderaj, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të keqpërdorimit të fletëvotimeve, në vendvotimin 2104b/02D, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura më datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa Anr.675/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të keqpërdorimit të fletëvotimeve në vendvotimin nr. 2104B/02D, ashtu që **I NDALOHET** Milazim Veseli me nr. të letërnjoftimit [REDACTED] Kryesues i Vendvotimit nr.2104B/02D, në Skenderaj, pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, nga dita e marrjes së vendimit.

II. REFUZHET e pabazuar, pjesa e ankesës me të cilën ka kërkuar që të përsëritet votimi në Vendvotimin 2104B/02D.

A r s y e t i m

Me datën 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë Subjektit Politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Skenderaj, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se në vendvotimin numër 2104b/02D, gjatë procesit të votimit janë hasur parregullsi duke evidentuar tre (3) fletëvotime të pavulosura në kutinë e votimit për kryetar komune. Po ashtu sipas parashtruesit të ankesës gjatë këtij procesi është vërejtur se i njëjti person ka votuar 15-16 herë për persona me asistim.

PZAP, më datë 19.10.2021 i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesë për përgjigje lidhur me ankesën Anr.675/2021 me të cilën ka kërkuar që t'i ofrojë PZAP-së Librin e Vërejtjeve për vendvotimin nr.2104b/02D, në Skenderaj duke i dhënë mundësinë që të përgjigjet deri më datë 19.10.2021 në ora 15:00 si dhe përmes emailit zyrtar të PZAP-së është kërkuar dhënia e deklaratës nga ana e kryesuesit të vendvotimit nr.2104b/02D, në Skenderaj.

Duke vepruar sipas kërkesës së PZAP-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 19.10.2021 ka paraqitur pranë PZAP-së Librin e Votimit për Vendvotimin nr.2104b/02D, në Skenderaj. Po ashtu, sipas kërkesës së PZAP-it, me datë 20.10.2019 përmes emailit zyrtar të PZAP-së është pranuar edhe deklarata e Milazim Veseli kryesuesi në vendvotimin nr.2104b/02D, në Skenderaj.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura, konstatoi se ankesa është pjesërisht e bazuar në pjesën që ka të bëjë se në vendvotimin lëndor janë tre fletëvotime për Kuvend Komunal të pa vulosura në kutin e votimit, kjo është konstatuar nga shkresat e ofruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, andaj në raport me këto parregullsi paneli vendosi si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”*. Lëshimet e pretenduara dhe te konstatuara nga paneli i atribuohen përgjegjësisë se kryesuesit të vendvotimit sipas nenit 74.10, pasi integritetit i procesit mbetet përgjegjësi e kryesuesit. *Me nenin 74.10 të LZP-së përcaktohet “ KVV-ja është përgjegjëse për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotim nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga KKZ-ja”*.

Në raport me pjesën refuzuese për urdhërimin e përsëritjes së votimit Paneli i vlerëson se mospërputhja e rezultatit konstatuar si më lart nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar, bazuar në nenin

117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindës se ka pas parregullsi të asaj natyre për te ndikuar në vendimmarrje ndryshe në këtë rast, siç është vendosur në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga arsyet e lartcekura paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.675/2021 më datën 20.10.2021.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.